



Prishtinë: 12.10.2012

Kodi i ZRRE-së: V_468_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_794_05_12

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_794_05_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 14.06.2012.

Në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2012 nxorri këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin B. K. (shifra në KEK: DPZ – 15154), nga Prizreni, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_794_05_12 i datës 18.05.2012.

Arsyetim

Në periudhën e muajit shtator të vitit 2009 punëtorët e KEK-ut kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 1749052 dhe kanë vendosur për matje njehsorin nr. 45448503 dhe i njëjti është dërguar ne qendrën e kalibrimit për verifikim.

Punëtorët e qendrës së kalibrimit me datë 24.11.2009 kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 1749052 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik dy bllozmat shtetërore i ka të këputura, ndërsa tjetra është në rregull, nga ana e jashtme njehsori pjesën kyçese e ka të djegur, për rreth qelqit nga ana e djathtë është futur shiriti filmik, është prerë kufizuesi i qelqit dhe është penguar puna e diskut, në brendi të njehsorit ka pluhur dhe copë të shiritit filmik.

Pas kësaj Departamenti i Faturimit në KEK me datë 25.03.2010 ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ10HP05226 në vlerë prej 456.44€. Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike si dhe duke kërkuar nga KEK-u ta shkarkoj edhe nga borxhi i mëhershëm. Departamenti për Konsumator në KEK ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit, ku edhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjegjës nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për bartjen e borxhit të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 30.07.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që: i) të veprojnë konform Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2008/5, ku për periudhën për të cilën ka qenë nën mbikëqyrje nga KPA duhet të ngrihet si kontest ku edhe duhet të shkarkojë nga borxhi shifrën DPZ - 15154 deri në momentin e lëshimit të Protokollit mbi dorëzimin e çelësave me



datë 24.03.2006 nga Agjencioni Kosovari i Pronës; ii) për pjesën sa i përket çështjes së faturës së rikthimit të humbjeve DPZ10HP05226 të datës 25.03.2010 si dhe borxhit të krijuar nga ana e uzurpatorëve nga periudha 24.03.2006 (Protokoli për dorëzimin e çelësave) e deri ne momentin e lidhjes se kontratës me datë 03.12.2008, KEK-u mund ta kërkoj në procedurë gjyqësore; iii) Pas kontestimit të shumave të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, KEK-u duhet të ndërroi emrin në shifrën DPZ - 15154, që deri më tani ka qenë në emër të A. A. dhe tani e tutje a shifra DPZ - 15154 duhet të faturohet në emër të B. K. tani si pronar i ligjshëm.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 14.06.2012 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, me të cilën ka kundërshtuar pjesërisht vendimin e DMK-së nr. **ZRRE/DMK_V_794_05_12** të datës 18.05.2012, dhe njëherit ka propozuar që aprovet kundërshtimi i KEK-ut dhe borxhi i theksuar më sipër të ngelet kontest deri në përfundimin e të gjitha procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 tetor 2012 ka analizuar dëshmitë e paraqitur nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit për ndarjen dhe formën e kërimit të borxhit të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar kontratën mbi shitblerjen e paluejtshmërisë – shtëpisë e cila është e lidhur me datë 03.12.2008 mes M. M. dhe B. K. dhe e cila kontratë është vërtetuar edhe në Gjykatën Komunale në Prizren si dhe shkresën e lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës me datë 19.01.2009 në të cilën është theksuar se z.B. L. është vendosur në pronën e cekur me datë 24.03.2006 në adresën JNA nr. 88 Prizren si pronar i ligjshëm dhe ka kërkuar që të shqyrtohet rasti i tij rreth shpenzimeve të larta të energjisë elektrike. Po ashtu është analizuar edhe protokoli mbi dorëzimin e çelësave të Agjencionit Kosovari të Pronës të datës 24.03.2006. Sipas kësaj vërehet se prona të cilën e potencon konsumatori ka qenë e uzurpuar dhe nën administrimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banësore dhe se shpenzimet e energjisë elektrik nuk i ka bërë pronari i tanishëm.

Është analizuar edhe shpenzimi i energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik nr. 1749052 dhe me njehsorin e ri elektrik nr. 45448503 dhe vërehet se ka rritje të shpenzimit me njehsorin e ri si dhe vërehet se në periudhat që dyshohet se kur është manipuluar njehsori elektrik kanë pas një shpenzim ma të ulët të energjisë elektrike krahasuar me periudhat kohore pas ndërrimit te njehsorit elektrik. Po ashtu janë analizuar edhe listat e leximit të KEK-ut dhe se sipas listave të leximit të shihet se njehsori elektrik duke përfshi periudhën kohore nga 11/2007 tregon se njehsori elektrik ka qenë i manipuluar me herët sipas konstatimit të lexuesit të KEK-u.

Sa i përket çështjes së rikthimit të humbjeve DMK në bazë të analizave që ka bërë nga rrjedha e energjisë elektrike nga periudha e marrjes në shfrytëzim nga pronari tani i ligjshëm, nuk kemi vërejtur se shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike ka mund të bëhet ndonjë keqpërdorim i mundshëm, pasi që prej kohës kur ka filluar të jetoj në këtë shtëpi dhe të faturohet i njëjti ka një shpenzim po thuajse të njëjtë të energjisë elektrike.

Duka pas parasysh se nenin 1 të Urdhëresës Administrative 2004/2 dhe Në Nenin 2 të Urdhëresës Administrative nr. 2008/5, ku theksohet se borxhi i krijuar i mëhershëm nga persona që e kanë shfrytëzuar banesën në formë jo-legale ose gjatë periudhës së shfrytëzimit legjitim nga ndonjë person ndryshe nga bartësi legal i pronës sipas skemës qiradhënëse të Agjencionit Kosovari për Prona, ky borxh nuk do t'i ngarkohet personit i cili është përcaktuar si pronar i ligjshëm nga Agjencioni Kosovari për Prona, si dhe duke pasur parasysh edhe kontratën e shitblerjes së paluajtshmërisë së datës 03.12.2008, Bordi ka vlerësuar se DMK ka vepruar drejtë në vendimin e tyre.

Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se KEK-u në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu ankesa e KEK-ut, nuk i përmban elementet bazë të një ankese pasi që është shumë e mangët për kah



përmbajtja. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirr në formën e përgjithësuar pa konkretizuar decidivisht se ku janë bërë shkeljet gjatë nxjerrjes së këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_794_05_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar